

Përmbledhje



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

RAPORTET E HARTUARA NGA INSTITUCIONET NDIHMËSE TË ORGANEVE TË VETTINGUT, GJATË SEANCËS DËGJIMORE NË KPK, NXITËN NEVOJËN PËR SPJEGIME SHITESË NGA ANA E ZNJ. MARIOLA MËRTIRI, PROKURORE PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

**RAPORTIM PARAPRAK I SEANCËS DËGJIMORE
DATË 05/12/2022 PRANË KPK:**

Proçesi i rivlerësimit për subjektin është realizuar bazuar në të tre kriteret: kriteri i pasurisë, kriteri i kontrollit të figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.,

Kriteri i pasurisë: Komisioni identifikoi problematika mbi burime të pamjaftueshme të familjarëve për blerjen e disa prej pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme.

Kontrolli i figurës: Komisioni konstatoi modeklarim të kontaktit të papërshtatshëm dhe të përfshirë në krim të organizuar në formularin e DSIK.

Vlerësimi i aftësive profesionale: U morën në shqyrtim 5 dosje profesionale të administruara nga ONM, dhe 6 denoncime të paraqitura nga publiku, ku për disa prej tyre u gjetën problematika dhe u kërkuar shpjegime.



**Raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse të organeve të vettingut, gjatë seancës
dëgjimore në KPK, nxitën nevojën për spjegime shtesë nga ana e znj. Mariola Mërtiri,
prokurore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**

Me datë 05.12.2022 ora 11:30, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Znj. Mariola Mërtiri, Prokurore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Trupa gjyqëse përbëhej nga znj. Etleva Çifte (Kryesuese), znj. Pamela Qirko (Anëtare) dhe z. Roland Ilia (Relator), si dhe u asistua nga vëzhguesi ndërkombëtar z. Willem Brower në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

KPK informoi se hetimi administrativ mbi subjektin e rivlerësimit është përfunduar për të tri kriteret, atë të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti nuk ushtroi të drejtën e përfaqësimit me avokat, nuk paraqiti kërkesa paraprake apo procedurale në lidhje me hetimin ose trupën gjyqëse, ndërkohë që trupa gjyqëse i dha mundësinë për të paraqitur parashtrime. Përlotja e subjektit të rivlerësimit shkaktoi një ndërpreje të seancës dëgjimore prej 10 minutash.

Sa i përket kriterit të pasurisë, hetimi administrativ i Komisionit, kishte konstatuar gjetje të ndryshme nga ILDKPKI. Ndërkohë që Komisioni identifikoi problematika mbi burime të pamjaftueshme të familjarëve për blerjen e disa prej pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, subjekti i rivlerësimit i kundërshtoi këto gjetje me pretendimin se në analizë nuk ishin përllogaritur të ardhurat e përfituara nga kthimi i një huaje pa deklaratë noteriale, ekonomia bujqësore, paga dhe dhënia me qera e një automjeti.

Gjithashtu, ndryshe nga DSIK, Komisioni relatoi vlerësimin e tij mbi kriterin e figurës. Subjekti i rivlerësimit u relatua se nuk ka plotësuar në mënyrë korrekte formularin e deklaramit pranë DSIK, ndërkohë që informacion i është kërkuar edhe SPAK, për marrëdhënien e biznesit të krijuar ndërmjet vëllait të bashkëshortit dhe bashkëjetueses së tij, me persona të përfshirë në krim të organizuar. Përdorimi i automjeteve të të afërmeve të dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 245 dhe 287 (në bashkëpunim), nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, nxiti diskutime ndërmjet trupës gjyqëse dhe subjektit të rivlerësimit. Kjo e fundit deklaroi shkëputjen e çdo kontakti me personat e dyshuar, prej momentit të ngarkimit të tyre me përgjegjësi penale. Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit bazohej në çështje të përzgjedhura nga subjekti dhe ato të shortuara, si dhe ankesa të depozituara pranë Prokurorisë së Përgjithshme, KLP, 5 dosje profesionale të administruara nga ONM, e 6 denoncime të paraqitura nga publiku.

Spjegime shtesë u kërkuar për ankesën e depozituar nga qytetarja R.K., mbi mosrespektim të afateve të hetimit për procedimin penal të iniciuar ndaj saj, sipas nenit 323 e në vijim të K.Pr. Penale. Pasi vepra penale është kryer në Gjermani e për këtë pritej përgjigjia mbi letër-porositë,

subjekti i rivlerësimit me vendim të ndërmjetëm ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, e më pas është larguar me leje lindje.

Subjekti i rivlerësimit ishte përfshirë në hetimin e dy procedimeve penale të viteve 2012 dhe 2015, ndaj një shoqërie aksionare, në të cilën bashkëshorti i saj rezultonte i punësuar, duke krijuar premisa për ushtrim funksioni nën kushtet e konfliktit të interesit. Faza e hetimeve paraprake e udhëhequr nga prokurorja, në vitin 2012 kur kompania dyshohej mbi nenin 258 KP, ishte shoqëruar me cënime procedurale në shtyrje të paarsyeshme të afateve hetimore, si dhe mos administrim në kohë të indicieve e provave.

Përpara dhënies së vendimit, në respektim të barrës së provës, trupa gjykuese do vlerësonte spjegimet e subjektit mbi vendimmarrjen e mosfillimit të dhënë në vitin 2020, ndaj ish-gjyqtarit A.B., të dyshuar për veprat penale “Mashttrim”, “Fshehje e aseteve”, “Shperdorim detyre”, “Mosdeklarim”, “Fshehje ose deklarim i rremë i pasurisë”.

Seanca dëgjimore u përmbyll me diskutimin ndërmjet vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së dhe subjektit të rivlerësimit, mbi pozicionin e bashkëshortit në subjektet tregtare ndaj të cilave SPAK ka regjistruar procedim penal, si dhe mbi marrëdhëniet që ai ka me kontaktet e papërshtatshme.

Seanca për shpalljen e vendimit nga KPK u caktua më datë 07.12.2022 ora 09:30.